

## **HYRJE**

VEA Travel operator, me nipt L61830017D dhe numer license turistike LN-4350-01-2018 per veprimtare si operator turistik (më tej “agjencia”) është një operator turistik që ofron pushime gjatë gjithë vitit. Kompania e mbështet punën e saj në një staf shumë profesional dhe me një experience, ofron paketa Brenda dhe jashte Shqiperise si Ture me autobus , Toure me avion, Paketa Individuale , ne gjithe Europen e vende te tjera.

## **KONTRATE E PERGJITHSHME ME KLIENTIN**

### **1. BAZA LIGJORE**

VKM nr. 65, datë 21.1.2009, “Për kontratat e paketave të udhëtimit”.

Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e Konsumatorëve” i ndryshuar.

Ligji Nr .9734, datë 14.5.2007, “Për Turizmin”.

Ligj nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

### **2. FUSHA E ZBATIMIT**

Kjo kontratë rregullon marrëdhënien kontraktore për paketat e udhëtimit midis organizatorit dhe/ose shitësit dhe konsumatorit.

Parashikimet e kësaj kontrate mbi organizatorin vlejné në mënyrë të njëjtë edhe për shitësin, pasi shitësi është solidarisht përgjegjës me organizatorin për detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

### **3. PERKUFIZIME**

“Kontratë”: është marrëveshja e lidhur ndërmjet konsumatorit me organizatorin dhe/ose shitësin në të cilën konsumatori detyrohet të paguajë një çmim të caktuar gjithëpërfshirës përkundrejt paketës së udhëtimit të ofruar nga pala organizuese.

“Paketë udhëtimi”: është shërbimi që i siguron konsumatorit një kombinim të parapërgatitur të jo më pak se dy nga llojet e mëposhtme të shërbimeve: (i) transporti; (ii) strehimi; (iii) shërbime të tjera turistike, që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me transportin ose strehimin dhe që përbëjnë pjesë të konsiderueshme të paketës; si dhe mbulon një periudhë kohore prej jo më pak se 24 orë ose që përfshin strehimin, të paktën për një natë.

“Agjenci”: Person juridik i regjistruar i cili kryen veprimtarinë e ofrimit, gjetjes dhe mundësimit të udhëtimeve turistike, biletave të udhëtimit në mënyra të ndryshme transporti si dhe bileta për aktivitete sportive ose kulturore për klientët, në këmbim të pagesës.

“Rezervim”: ruajtja ose porosia e një produkti turistik si udhëtimi, akomodimi ose paketë

turistike nga ana e agjencisë, me porosi të klientit.

“Konfirmim”: a) verifikimi i disponibilitetit të një rezervimi, ose b) marrëveshja përfundimtare me anë të së cilës klienti shlyen detyrimet ndaj agjencisë dhe agjencia ruan përfundimisht rezervimin e klientit.

“Hotel”: ndërtesë ose një grup i lidhur ndërtesash të pavarura nga ndonjë vendodhje ndërtimi tjetër, me jo më pak se 6 (gjashtë) dhoma, brenda një parcele toke të vetme, në të cilën akomodimi, shërbimet shtesë dhe komoditeti ofrohen për publikun nga një staf i kualifikuar.

“Rimbursim”: shuma e parave që agjencia është e detyruar t’i kthejë klientit në rast të mospërmbushjes së marrëveshjes për faj të saj ose në rastet e parashikuara në këtë dokument.

## **4. AGJENCIA**

### **4.1. Detyrime të agjencisë**

**4.1.1.** Stafi i agjencisë është i detyruar të shpjegojë të gjitha ofertat për të cilat klienti shpreh interes. Stafi i agjencisë është i detyruar të përgjigjet, brenda orarit zyrtar dhe në mënyrën e caktuar me marrëveshje, për çdo pyetje apo paqartësi të klientit.

**4.1.2.** Stafi i agjencisë është i detyruar ti ofrojë konsumatorit, me shkrim ose në një formë tjetër të përshtatshme, përpara lidhjes së kontratës, një informacion të përgjithshëm për kërkesat e zbatueshme për vizat dhe pasaportat, veçanërisht, për afatet kohore për pajisjen me to, si dhe informacion për formalitetet shëndetësore, për udhëtimin dhe qëndrimin.

– Pasaporta shqiptare për udhëtimet me charter duhet të ketë vlefshmëri mbi 6 muaj.

– Pajisja me vizë: Në rastet kur agjencia përgatit paketa turistike për udhëtime në destinacione ku kërkohet pajisja me vizë e qytetarëve shqiptarë, agjencia do të lehtësojë procesin e aplikimit për klientët e saj duke mbledhur dokumentet dhe dërgimin në ambasadat përkatëse. Agjencia nuk mban asnjë përgjegjësi nëse klientit nuk i akordohet viza hyrëse. Klienti gjithashtu informohet për kostot shtesë të aplikimit për vizë, në rastet kur kjo nuk është e përfshirë në çmimin e paketës.

– Siguracioni në udhëtim: Siguracioni shëndetësor nuk përfshihet në çmimin e paketës, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe. Në çdo rast klienti do të këshillohet për domosdoshmërinë e siguracionit i cili mbulon kostot e asistencës përfshirë riatdhesimin, në rast aksidenti ose sëmundje.

**4.1.3.** Stafi i agjencisë është i detyruar të shpjegojë procedurën që do të kryhet në mënyrë që të mundësohet udhëtimi sipas kërkesave të klientit si dhe dokumentet e nevojshme që klienti duhet të paraqesë në agjenci.

**4.1.4.** Stafi i agjencisë është i detyruar të përgjigjet sa më mirë nevojave të klientit për sa i përket rezervimit të hotelit, transportit etj. Nëse klienti ka zgjedhur të pranojë njërin nga ofertat e përgatitura nga agjencia, atëherë stafi i agjencisë do të përgjigjet vetëm për hotelet dhe transportin e përcaktuar në ofertë.

**4.1.5.** Agjencia deklaron se është përgjegjëse për çdo ofertë të reklamuar në faqen online [www.veatravel.com](http://www.veatravel.com), në broshurat informuese dhe katalogët e prodhuara prej saj, si dhe çdo ofertë të reklamuar nga stafi i agjencisë.

**4.1.6.** Agjencia nuk është përgjegjëse për dëmtim ose humbje të bagazheve ose sendeve personale në avion, aeroport, port, anije ose në hotel.

## **4.2 Informacioni paraprak**

**4.2.1.** Staf i agjencisë është i detyruar t'ju sigurojë 7 ditë para fillimit të udhëtimit: Emrin e shoqërisë, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të tij vendor në vendin që do të vizitohet dhe, në mungesë të një përfaqësuesi, të dhëna për të kontaktuar agjencitë vendore, të vendit që do të vizitohet, të cilat mund t'i japin asistencë konsumatorit, nëse ndodhet në vështirësi.

**4.2.2.** Në rast mungese të agjencive të tilla vendore, stafi i agjencisë do t'ju japë një numër telefoni emergjence ose çdo informacion tjetër, që ju mundëson kontaktimin me organizuesin.

**4.2.3.** Staf i agjencisë detyrohet t'ju informojë për oraret dhe vendet e ndalesave të ndërmjetme dhe të pikave lidhëse të udhëtimit, si dhe të japë hollësi për vendet, që do të zihen nga udhëtari, si kabina ose shtrati në anije, ndarjet e fjetjes në tren. Në rregullat e agjencisë është parashikuar shoqërimi i grupeve me guide profesionale, vendase dhe shqiptare, si për programet kulturore ashtu dhe për paketat e pushimeve, të cilët jo vetëm ju informojnë për detajet e udhëtimit por edhe janë pika juaj e kontaktit me agjencinë për çdo problem të mundshëm.

**4.2.4.** Agjencia do t'ju vendosë në dispozicion kontratën e sigurimit me një shoqëri sigurimi e cila mbulon përgjegjësinë e saj për dëmet e shkaktuara, si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe falimentimit.

**4.2.5.** Staf i agjencisë është i detyruar t'ju njoftojë me shkrim, për të gjitha kushtet e kontratës, si dhe t'ju japë një kopje të këtyre kushteve.

## **4.3 Anullimet**

**4.3.1** Agjencia nuk është përgjegjëse në rast të anulimit të udhëtimit për shkak të forcës madhore, shkaqeve natyrore, protestave popullore ose shpalljeve të gjendjes së luftës në destinacionin e përzgjedhur nga klienti si dhe për çdo incident që ndodh për shkak të këtyre arsyeve. Zgjidhja do të gjendet me marrëveshje mes agjencisë dhe klientit.

**4.3.2.** Në rast se nuk përmbushet numri minimal i pjesëmarrësve i parashikuar për organizimin e paketës, atëherë agjencia ka të drejtë të anultojë udhëtimin. Parashikimi i numrit minimal varion sipas destinacionit dhe periudhës së vitit kur promovohet një paketë, megjithatë do të bëhet gjithmonë i ditur në momentin e publikimit të paketës . Konsumatori do të njoftohet për këtë anulim 15 ditë përpara nisjes së udhëtimit.

**4.3.3.** Nëse agjencia anulon paketën përpara datës së nisjes, për të cilën është rënë dakord, konsumatorit i lind e drejta të zgjedhë njërën nga mundësitë e mëposhtme:

– Ofrimin e një paketë zëvendësuese, ekuivalente ose të një cilësie më të lartë, kur organizatori a shitësi janë në gjendje t'ia ofrojnë

– Ofrimin e një pakete udhëtimi zëvendësuese, me një cilësi më të ulët. Në një rast të tillë organizatori ose shitësi duhet t'i kompensojnë klientit diferencën e çmimit ndërmjet paketës së udhëtimit të anuluar dhe asaj të ofruar;

– Kthimin e të gjithë shumës së paguar nga konsumatori, sipas kontratës së paketës së udhëtimit, brenda 7 ditëve nga data e dhënies së njoftimit për heqjen dorë.

**4.3.4.** Në të kundërt konsumatorit i lind e drejta të kërkojë kompensim nga organizatori, për të gjitha dëmet, materiale dhe jomateriale, përveç parashikimeve të përcaktuara në pikën 4.3.1 dhe 4.3.2 të kësaj kontrate.

**4.3.5.** Konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata pa penalitet deri në 25 ditë përpara nisjes së udhëtimit.

**4.3.6.** Në rast se konsumatori heq dorë nga kontrata në kapërcim të afatit të mësipërm atëherë ai

detyrohet të kompensojë agjencinë për shpenzimet e kryera për rezervimin tij. Shuma do të përcaktohet në përputhje me afatet e anulimit të përcaktuara në këtë kontratë.

#### **4.4 Procedurat e anulimit**

Anullimi do të quhet se është kryer në momentin që klienti paraqitet në njërin nga zyrat e agjencisë dhe plotëson formularin përkatës për t'u tërhequr nga marrëdhënia e krijuar me agjencinë. Klienti duhet të paraqitet personalisht ose i përfaqësuar nga një pjestar i grupit (kur udhëtimi është rezervuar në grup). Në këtë rast, klienti duhet të telefonojë agjencinë, ndërkohë që përfaqësuesi është në zyrën e agjencisë, për të konfirmuar anulimin.

#### **4.5 Detyrimet e agjencisë pas nisjes së udhëtimit**

Agjencia është e detyruar të përmbushë në mënyrë korrekte dhe tërësore të gjitha shërbimet që cilësohen në kontratë, pavarësisht se nënkontraktorë apo furnitorë të ndryshëm janë ngarkuar me detyrimet përkatëse.

#### **4.6 Të drejtat e agjencisë**

**4.6.1.** Agjencia ka të drejtë të kërkojë çdo dokument të nevojshëm që mundëson realizimin e rezervimit të udhëtimit.

**4.6.2.** Agjencia ka të drejtë të marrë, në kohën dhe në mënyrën e caktuar me marrëveshje, çdo pagesë që klienti detyrohet.

**4.6.3.** Agjencia ka të drejtë të anulojë rezervimin e udhëtimit nëse klienti nuk kryen pagesat sipas marrëveshjes.

**4.6.4.** Në rast anulimi të udhëtimit, agjencia ka të drejtë të mbajë nga shuma e paguar nga klienti, çdo komision apo shpenzim që ajo është detyruar të bëjë në mënyrë që të mundësohet udhëtimi i klientit.

### **5. KLIENTI**

#### **5.1 Të drejtat e klientit**

**5.1.1.** Klienti ka të drejtë të përfitojë nga oferta sipas informacioneve të dhëna nga stafi i agjencisë.

**5.1.2.** Klienti ka të drejtë të kërkojë informacion të detajuar mbi udhëtimin gjatë orëve të punës së agjencisë, në mënyrat e kontaktit të caktuara nga agjencia.

**5.1.3.** Klienti ka të drejtë të kërkojë rimbursim në rast të anulimit të udhëtimit për faj të agjencisë, në rast të ndryshimit të hotelit ose transportit për faj të agjencisë, në rast të mos plotësimit të paketës së ofruar nga agjencia.

**5.1.4.** Klienti ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata e paketës së udhëtimit, pa asnjë shpenzim a penalizim nëse organizatori nuk është në gjendje t'i sigurojë kontratën e vlefshme të sigurimit

#### **5.2 Detyrime të klientit**

**5.2.1.** Klienti është i detyruar të kryejë pagesat sipas marrëveshjes së caktuar me agjencinë.

**5.2.2.** Klienti është i detyruar të paraqitet në vendin e nisjes në datën dhe orën e caktuar nga agjencia.

- 5.2.3.** Klienti është i detyruar të japë numrin e pjesëmarrësve në udhëtim, nëse ai është përgjegjës për ta, ose nëse bëhet fjalë për udhëtim në grup.
- 5.2.4.** Konsumatori është detyruar të sillet në mënyrë korrekte dhe sipas ligjeve dhe normave etike të vendit pritës ku organizohet udhëtimi, sipas udhëzimeve të organizatorit. Konsumatori është i detyruar të dëmshpërblejë organizatorin për ndonjë dëm që rrjedh nga mosrespektimi i këtij detyrimi.
- 5.2.5.** Klienti është i detyruar të përcaktojë nëse do të marrë edhe kafshë shtëpiake me vete.
- 5.2.6.** Klienti është i detyruar të përcaktojë nëse do të ketë në ngarkim të mitur. Për të miturit që udhëtojnë pa praninë e të dy prindërve, nevojitet pajisja me prokurë nga prindërit.
- 5.2.7.** Klienti është i detyruar të njoftojë për çdo mospërmbushje të kontratës së paketës turistike, të cilën ai e dallon në vend, furnizuesin e shërbimit në fjalë dhe agjencinë, me shkrim ose në një formë tjetër të përshtatshme, me mundësinë më të parë.
- 5.2.8.** Në rast se konsumatori heq dorë nga kontrata në kapërcim të afatit të mësipërm atëherë ai detyrohet të kompensojë agjencinë për shpenzimet e kryera sipas kushteve të përcaktuara për afatet e anulimit.

## **6. TRANSFERIMET APO NDRYSHIMET**

- 6.1.** Konsumatori në kontratën e paketës së udhëtimit, ka gjithashtu të drejtën të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij te një palë e tretë, që i përmbush kushtet e parashikuara në paketën e udhëtimit. Në një rast të tillë, konsumatori ka detyrimin të njoftojë agjencinë, 15 ditë përpara nisjes, për qëllimet e transferimit të rezervimit të tij te një palë e tretë.
- 6.2.** Konsumatori, i cili transferon të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kontratës së paketës së udhëtimit dhe personi, te i cili transferohet paketa e udhëtimit, janë përgjegjës, solidarë dhe veçmas, tek agjencia për pagesën e një shume të caktuar nga çmimi i përgjithshëm dhe për çdo kosto shtesë, që rrjedh nga ky transferim. Shuma që do të paguhet varion në varësi të kohës së njoftimit si dhe kostove që vendosen nga furnitorët përkatës.
- 6.3.** Stafi i agjencisë është i detyruar të mundësojë një ndërrim të itinerarit sipas kërkesave të klientit, brenda limiteve të përcaktuara në këtë marrëveshje. Nëse ky ndryshim kërkon një kosto financiare, kjo kosto do të paguhet nga klienti.

## **7. AFATET**

- 7.1.** Afati për të kryer një rezervim është të paktën 14 (katërmëdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për kryerjen e një udhëtimi. Agjencia nuk është përgjegjëse nëse edhe brenda këtij afati, nuk ekzistojnë vende të lira në hotel ose në mjetin e transportit.
- 7.2.** Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai përpara 21 (njëzete e një) ditë ose më shumë ditë përpara udhëtimit, klientit i kthehet shuma e plotë e paguar në emër të agjencisë. Nëse përpara anulimit është bërë ndonjë shpenzim, ky shpenzim do të zbritet nga shuma që do të marrë klienti. Shpenzimet përfshijnë edhe komisionin bankar në rastin e pagesës me kartë krediti ose debiti.
- 7.3.** Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai 10 (dhjetë) deri 20 (njëzetë) ditë përpara udhëtimit, klienti ka të drejtë të rimbursohet deri në 50% të shumës së paguar për rezervimin. Klienti do të paguajë shpenzimet e transfertës dhe shpenzime administrative që mund të jenë kryer për shërbimin ndaj tij. Shpenzimet përfshijnë edhe komisionin bankar

në rastin e pagesës me kartë krediti ose debiti.

**7.4.** Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai 4 (katër) deri 9 (nëntë) ditë përpara udhëtimit, klienti ka të drejtë të rimburohet deri në 30% të shumës së paguar për rezervimin. Klienti do të paguajë shpenzimet e transfertës dhe shpenzime administrative që mund të jenë kryer për shërbimin ndaj tij. Shpenzimet përfshijnë edhe komisionin bankar në rastin e pagesës me kartë krediti ose debiti.

**7.5.** Nëse rezervimi i bërë nga klienti anulohet nga vetë ai në më pak se 3 (tre) ditë përpara udhëtimit, klienti nuk ka të drejtë të rimburohet nga agjencia.

**7.6.** Nëse klienti nuk paraqitet ose largohet nga udhëtimi më përpara datës së parashikuar nga agjencia, klienti nuk ka të drejtë të rimburohet nga agjencia.

## **8. ÇMIMET**

**8.1.** Përcaktimi i çmimit: Çmimi i paraqitur në faqen online veatavel.com, ose çmimi i marrë nga stafi në secilën prej zyrave të agjencisë, është çmimi përfundimtar i paketës ose ofertës turistike.

**8.2.** Agjencia është e detyruar të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur konsumatorin, nëse përpara nisjes së udhëtimit, është e detyruar të kryejë ndryshime të rëndësishme në ndonjërin nga kushtet thelbësore të kontratës së paketës së udhëtimit, apo të rrisë çmimin në një masë më të lartë se 5% të çmimit përfundimtar të rënë dakord mes palëve, për t'i mundësuar atij marrjen e vendimeve të duhura dhe, në veçanti:

– Pranimin e një shtojce në kontratë, duke specifikuar ndryshimet e bëra dhe ndikimin e tyre në çmim.

– Heqjen dorë nga kontrata, pa penalizim, duke njoftuar agjencinë brenda tre ditëve nga marrja njoftim por jo më vonë se dita e nisjes.

**8.3.** Agjencia nuk është përgjegjëse për ndryshimet në çmimin përfundimtar nëse ky ndryshim bëhet nga ana e hotelit, shtimit të taksave që paguhet në destinacion, detyrime të tjera të vendosura nga institucione shtetërore shqiptare ose të huaja. Për çdo rast agjencia do të njoftojë klientin sapo të jëtë njoftuar nga furnitorët e saj apo institucione të tjera.

**8.4.** Agjencia nuk është përgjegjëse për ndryshimet e çmimit në periudha të caktuara të vitit që konsiderohen si piku turistik i destinacionit të zgjedhur nga klienti. Pagesat për fëmijët ndryshojnë sipas ofertave të hotelit. Agjencia nuk është përgjegjëse për këto pagesa dhe për ndryshimet që mund të bëhen në çmim.

**8.5.** PAGESA kryhet në total, në momentin e rezervimit. Sidoqoftë, në marrëveshje me agjencinë, pagesa mund të bëhet edhe e ndarë në dy pjesë kur, 50% e çmimit përfundimtar paguhet në momentin e rezervimit dhe 50% paguhet 14 ditë përpara udhëtimit. Në rast mos pagese, agjencia nuk është e detyruar të mbajë rezervimin e kryer nga klienti. Agjencia mund të ndryshojë afatin prej 14 ditësh në periudhë të veçanta gjatë vitit që konsiderohen piku turistik.

### **8.6 Mënyra e kryerjes së pagesës**

**8.6.1.** Me para në dorë në zyrat e agjencisë dhe në zyrat e agjencive partnere

**8.6.2.** Me anë të kartës e kreditit ose debitit Visa, Mastercard, Visa Electron dhe Maestro me anë të makinerisë, nëse klienti paraqitet personalisht në zyrë.

**8.6.3.** Me anë të transfertës bankare në llogarinë e agjencisë. Në këtë rast, klienti është i detyruar

të dërgojë me faks ose e-mail një kopje të fletëpagesës së kryer në bankë.

## **9. ANKESAT**

**9.1.** Konsumatori ka të drejtë të ankohet tek organizatori, për çdo mospërmbushje të kontratës, brenda afatit prej 10 ditësh nga përfundimi i udhëtimit. (Përfshirë këtu dhe detyrimin e klientit për të njoftuar menjëherë mospërmbushjen e kontratës.)

**9.2.** Organizatori detyrohet të shqyrtojë ankesën dhe të kthejë përgjigje brenda afatit prej 20 ditësh nga marrja dijani për ankesën.

## **10. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Në rast mosmarrëveshje me klientin, agjencia do të bëjë çdo përpjekje për të arritur në një zgjidhje me marrëveshje dhe të shpejtë me klientin.

## **11. E DREJTA E AUTORIT**

**11.1.** “VEA Travel” (Edvin Dusha P.F) deklaron se faqa online veatravel.com është pronë e saj. Agjencia mban përgjegjësi për çdo material të pasqyruar në njërin nga faqet online.

**11.2.** “VEA Travel” (Edvin Dusha P.F) deklaron se informacioni mbi hotelet, rezortet dhe mjetet e transportit është marrë nga faqet zyrtare të hoteleve, rezorteve dhe mjeteve të transportit. Ky informacion rishikohet herë pas here në mënyrë që në faqe të jetë vetëm informacioni më i fundit.

**11.3.** “VEA Travel” (Edvin Dusha P.F) deklaron se në faqen e saj online pasqyrohet vetëm informacion i lejuar për publikun nga krijuesit e faqeve të hoteleve, resorteve dhe mjeteve të transportit. Informacioni dhe fotografitë nuk merret personalisht nga stafi i agjencisë, por vetëm nga faqet zyrtare të sipërcituara.

**11.4.** “VEA Travel” (Edvin Dusha P.F) deklaron se nuk ka të drejtë autori mbi materialin e cituar në pikën 11.3.

## **12. MIRATIMI I KONTRATES**

Miratimi i marrëveshjes së mësipërme bëhet nga personi juridik Edvin Dusha ne krye te “VEA Travel” (Edvin Dusha P.F)

Çdo ndryshim në marrëveshjen e mësipërme bëhet nga personi juridik Edvin Dusha ne krye te “VEA Travel” (Edvin Dusha P.F)

---

## ***Politikat e Privatesise***

“VEA Travel”, ju informon se, me qëllim për t’ju ofruar një shërbim sa më të mirë dhe përgjigje të shpejtë ndaj kërkesave tuaja, në platformën online në faqet tona të internetit, kërkohet që klientët apo përdoruesit të japin disa të dhëna personale në formën e aplikimit online për të proceduar me rezervimin online.

“VEA Travel” disponon faqet zyrtare të internetit [www.veatravel.com](http://www.veatravel.com) dhe [www.veatravel.al](http://www.veatravel.al). Nëpërmjet këtyre faqeve, kompania u vjen në ndihmë klientëve të interesuar për paketa turistike apo cdo lloj shërbimi udhëtimi.

Të dhënat tuaja grumbullohen, përpunohen dhe ruhen nga VEA Travel në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Këto veprime do të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Dhënia e të dhënave tuaja personale nuk është e detyrueshme, por është kusht i domosdoshëm për të proceduar rezervimin tuaj online.

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë”, “VEA Travel” deklaron si me poshtë:

### **1. Perkufizimi i termave**

Në këtë marrëveshje, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

**1.1.** Agjenci: Person juridik i regjistruar i cili kryen veprimtarinë e ofrimit, gjetjes dhe mundësimin të udhëtimeve turistike, biletave të udhëtimit në mënyra të ndryshme transporti si dhe bileta për aktivitete sportive ose kulturore për klientët, në këmbim të pagesës.

**1.2.** Cookie: Një pjesë informacioni e dërguar nga një faqe interneti dhe që ruhet në browserin e përdoruesit ndërkohë që përdoruesi sheh faqen e internetit. Çdo herë që një përdorues hap një faqe interneti, browseri dërgon një cookie në serverin e përdoruesit për ta lajmëruar atë për aktivitetin e tij të mëparshëm.

### **2. Përdorimi i cookie**

**2.1.** Faqet e internetit që i përkasin agjencisë, i përdorin cookie për të dalluar vizitorët e faqes njëri nga tjetri. Disa cookie janë të domosdoshëm për mirëfunksionimin e faqeve të internetit të agjencisë, për të lejuar përdoruesit e faqes të bëjnë rezervime online dhe për të mundësuar stafin e agjencisë të marrë e të përpunojë kërkesat e klientëve. Për vizitorët e faqeve tona sistemi mbledh informacione standarde, për qëllime statistikore, (Psh: Për të parë se cili është numri i vizitorëve, gjithnjë pa i bërë ata të identifikueshëm).

**2.2.** Disa lloje të tjera cookie e ndihmojnë stafin e agjencisë të mundësojë një përvojë të mirë për klientët kur këta vizitojnë faqen e internetit. Cookie japin edhe informacion mbi ofertat e



agjencisë.

**2.3.** Cookie përdoren gjithashtu, për të reklamuar në faqen e internetit të agjencisë.

### **3. Deklarate mbi privatesinë**

**3.1.** “VEA Travel” respekton rëndësinë e privatësisë së klientëve të saj. Kjo deklaratë përcakton bazën mbi të cilën mblidhen dhe përpunohen të dhënat e çdo klienti. “VEA Travel” siguron çdo klient se të dhënat që mbërrijnë në backoffice apo që klienti nënshkruan personalisht në zyrë, janë të siguruar me anë të një sistemi të sigurtë dhe këto të dhëna përdoren vetëm për efekt të garantimit të rezervimit të klientit. Këto të dhëna administrohen nga persona të caktuar dhe me akses të kufizuar në to. Cdo agjent shitje i kompanisë i cili mbledh të dhëna për klientët, ka një detyrim kontraktual me kompaninë për respektimin e të dhënave personale që grumbullon gjatë punës së tij si dhe respekton disa rregulla të mirëpërcaktuara për kujdesin në mbrojtjen e të dhënave personale.

**3.2.** Të dhënat e mëposhtme të klientëve mblidhen nga faqja e internetit:

a) Informacioni që klienti jep në mënyrë që të kryhet rezervimi i udhëtimit;

b) Informacioni që klienti jep në mënyrë që të bëhet pjesë e një konkursi që reklamohet në faqen e internetit, kur plotëson një pyetësor ose kur raporton një problem;

c) Detaje të transfertave bankare që klienti kryen për të përfunduar një rezervim;

ç) Nëse klienti kontakton stafin e agjencisë, stafi mund të ruajë adresën e e-mail.

“VEA Travel” përdor një teknologji bashkëkohore për të mbrojtur sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave të klientëve, si dhe për të ndaluar aksesin në sistemin elektronik nga ana e personave të paautorizuar. Procedurat tona të sigurisë përmirësohen vazhdimisht me teknologji të reja. Ambjenti ku ruhen serverat dhe pajisje të tjera, survejohen me kamera dhe mund të aksesohen vetëm nga Administratori dhe Drejtori i Teknologjisë së Informacionit.

### **4. Ruajtja dhe transferimi i te dhenave**

**4.1.** Të dhënat e mbledhura nga agjencia vetëm për qëllime rezervimi dhe të lëna me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave mund të transferohen ose të ruhen në një vend jashtë Zonës Ekonomike Europiane. Gjithashtu, të dhënat mund të përpunohen nga stafi i hotelierisë ose mjeteve të transportit për të bërë të mundur udhëtimin dhe qëndrimin e klientit.

**4.2.** “VEA Travel” në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve që ka me furnitorë globalë, do të transferojë në database të tyre të dhënat e klientëve, të cilët rezervojnë nëpërmjet faqeve online të kompanisë. “VEA Travel” garanton ruajtjen e të dhënave personale të klientëve të saj sipas standarteve ndërkombëtare, të shprehura qartë në marrëveshjet e nënshkuara me këta furnitorë.

**4.3.** Të gjitha të dhënat e mbledhura nga agjencia do të ruhen në serverat e sigurtë të “VEA Travel”.

**4.4.** Të dhënat e mbledhura nga agjencia mund të përdoren edhe nga agjencitë partnere të “VEA Travel”.

**4.5.** Të dhënat e mbledhura nga agjencia mund të përdoren për të informuar klientët mbi ofertat e ndryshme të agjencisë.

## **5. Anullimi i perpunimit te te dhenave**

Klienti ka të drejtë të kërkojë nga agjencia të njihet me informacionin që mund të jëtë mbledhur për të dhe më pas të mos përpunojë të dhënat personale për qëllime marketingu apo arsye të ndryshme me anë të e-mail ose një kërkesë drejtuar kompanisë në adresën e kontaktit.

## **6. Pelqimi mbi mbrojtjen e te dhenave personale**

Duke vazhduar përdorimin e faqeve të internetit të “VEA Travel”, klienti jep pëlqimin e tij mbi mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga ana e agjencisë. Të dhënat personale do të ruhen për atë kohë sa ç’është e nevojshme sipas qëllimit kryesor të mbledhjes së tyre. Afatet e ruajtjes së të dhënave do të jenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi. Të dhënat e klienteve ruhen për atë sa është e nevojshme për të garantuar ofrimin e shërbimit. Nëse keni pyetje, vërejtje, kërkesa apo ankesa në lidhje me përdorimin e këtyre të dhënave nga ana e “VEA Travel”, atëherë lutemi të na drejtoheni me shkrim në adresën e mëposhtme:

Personi Përgjegjës për Privatesinë: “VEA Travel”, Rr. Muhamet Gjollësja, Pranë Shkolles Sabaudin Gabrani, Tiranë, Shqipëri



## ***TE DREJTAT DHE DETYRIMET***

Mirëserdhët në faqen tonë të internetit. Kjo faqe interneti ka për qëllim t’ju asistojë gjatë kërimit tuaj për udhëtimet që po planifikoni; t’ju japë informacion të plotë mbi llojshmërinë e shërbimeve që ne ofrojmë si dhe t’ju mundësojë kryerjen e rezervimeve për destinacionet që dëshironi. Përdorimi i shërbimeve tona, si në faqen e internetit apo dhe në çdo zyrë tonën është subjekt i kushteve, të drejtave dhe detyrimeve të poshtëpërmendura.

### **Rregulli për pasaportat shqiptare në udhëtime:**

PASHAPORTA SHQIPTARE DUHET TË JETË ME SHUMË SE 6 MUAJ E VLEFSHME PËR TË UDHËTUAR NË TURQI, AMERIKE DHE NË DESTINACIONET E CHARTERIMIT, NDErsa PËR UDHËTIMET NË VENDET TË TJERA 3 MUAJ VLEFSHMERI.